



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 27.02.2014

Nr. 0201-194

**PËR:** Ajnishahe Halimi, anëtare e Kuvendit të Komunës së Skenderajt nga VV  
Cenë Behrami, anëtarë i Kuvendit të Komunës së Skenderajt nga LDK  
Qazim Xani, anëtarë i Kuvendit të Komunës së Skenderajt nga AAK

**LËNDA:** Përgjigje në kërkesë

Të nderuar/a,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka pranuar kërkesën tuaj, për rishqyrtim të vendimit për formimin e Komitetit për Politikë e Financa të Kuvendit të Komunës së Skenderajt, pasi që në këtë komitet nuk janë përfshirë anëtarë nga subjektet që Ju i përfaqësoni.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011, për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë vlerëson se:

- Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës pa marr parasysh subjektin politik që përfaqëson;
- Bazuar në nenin 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përbërja e Komitetit për Politikë e Financa duhet të reflektoj përfaqësimin e entitete politike në Kuvendin e Komunës. Edhe pse shprehimisht nuk është përcaktuar formula e përfaqësimit në Komitetin për Politikë dhe Financa, në rastin konkret përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përbërjen e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës së Skenderajt;

Bashkangjitur me këtë përgjigje gjeni edhe konfirmimin e ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL;  
Ismet Salihu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Skenderajt  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së;  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 27.02.2014  
Br. 0201-194

**Za:** Ajnishahe Halimi, članica Skupštine Opštine Skenderaj iz Samoopredeljenja  
Cenë Behrami, član Skupštine Opštine Skenderaj iz LDK  
Qazim Xani, član Skupštine Opštine Skenderaj iz AAK

**Predmet:** Odgovor na zahtev

Poštovani-e,

Ministastarstvo Administracije Lokalne Samouprave (MALS) je primila vaš zahtev, za ponovno razmatranje odluke za formiranje Odbora za Politiku i Finansije Skupštine Opštine Skenderaj, pošto u ovom odboru nisu uključeni članovi od subjekta koje Vi predstavljate.

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za Lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011, o Poljima Administrativne Odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja navedenog zahteva ceni :

- Odbor za Politiku i Finansije predvodi Predsedavjući Skupštine Opštine bez obzira na politički subjekat kojeg predstavlja;
- Na osnovu člana 52.1 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, sastav Odbora za Politiku i Finansije treba da prikaže predstavljanje političkih etnitetu u Skupštini Opštine . Iako izražajno nije određena formula predstavljanja u Odboru za Politiku i Finansije, u konkretnom slučaju sastav Odbora za Politiku i Finansije prikazuje-reflektuje politički etnitet u Skupštinu Opštine Skenderaj;

Uz ovaj odgovor ćete naći i potvrdu zakonitosti odluke Skupštine Opštine Skenderaj za osnivanje Odbora za Politiku i Finansije.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera & Ministar MALS-a**

**Kopija:** Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a;  
Ismet Salihu, Predsedavjući Skupštine Opštine Skenderaj  
Rukovodiocima Uprava MALS-a;  
Arhivu MALS-a.



**Për:** Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti ligjor dhe Monitorim të Komunave, z. Agron Maxhuni


**CC:** Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së, z. Besnik Osmani

**Nga:** Anëtarët e Kuvendit Komunal – Skenderaj

Ajnishahe Halimi – Lëvizja VETËVENDOSJE!

Cenë Behrami – Lidhja Demokratike e Kosovës

Qazim Xani – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës



**Lënda:** Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë

**Data:** 07 shkurt 2014

Të nderuar,

Kuvendi Komunal në Skenderaj, me datën 31.01.2014 ka mbajtur mbledhjen e rregullt të thirrur nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Ismet Salihu. Sipas ftesës të cilën e kemi pranuar më datë 21.01.2014 me nr. të protokollit 1-006-2606, krahas kohës në të cilën do të mbahet mbledhja e Kuvendit Komunal, si rregull na janë kumtuar poashtu edhe pikat e rendit të ditës. Krahas çështjeve të tjera të cilat ishin përfshirë si pikat të rendit të ditës për t'u diskutuar, në pikën e 5-të të rendit të ditës është përfshirë – Konstituimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete si komitete të përhershme. Poashtu, në pikën 6 dhe 7 të rendit të ditës është paraparë themelimi i Komitetit për Mbrojtje dhe Shpërtim dhe Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Rini. Ndërsa, në pikën 8, 9 dhe 10 janë përfshirë propozim-vendimet për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për themelimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtë dhe afatgjatë.

Ndonëse, në bazë të Nenit 52 par. 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është paraparë se përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në kuvendin e komunës. Në mbledhjen e datës 31.01.2014 është votuar përbërja e këtij komiteti pa përfshirjen e subjekteve politike që janë në opozitë. Për më tej, subjekteve politike që janë në opozitë i është ofruar nga subjekti politik PDK që të emërojnë të gjitha subjektet opozitare një propozim për përfaqësimin e tyre në Komitet për Politikë dhe Financa. Në rend të parë, duke pasur parasysh dispozitën e Nenit 52 par. 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, një gjë e tillë është në kundërshtim me këtë dispozitë, dhe se një ujdë politike në mes të subjekteve politike do të ishte në kundërshtim të kësaj dispozite ligjore kur kihet parasysh se komitetet e përhershme duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit Komunal, që nënkupton përfshirjen e gjërë të të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend. Poashtu, edhe gjatë themelimit të Komitetit për Komunitete, në mënyrë selektive janë përjashtuar nga përfaqësimi anëtarët e Kuvendit Komunal nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, LDK dhe AAK. Poashtu, edhe në rastin e themelimit të



Komitetit për Komunitete, në cilësinë e komitetit të përhershëm, është cenuar dispozita e nenit 51.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku theksohet se nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e kuvendit të komunës.

Kuvendi Komunal i Skenderajt, poashtu ka diskriminuar opozitën gjatë themelimit të Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Rini, si dhe themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, ku në mënyrë të njëjtë këto subjekte politike janë përjashtuar nga përfaqësimi.

Andaj, duke konsideruar se këto vendime të Kuvendit Komunal të Skenderajt konsistojnë në kundërligjshmërinë lidhur me rregullimin e vetëqeverisjes lokale përkitazi me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kërkojmë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, respektivisht Departamenti ligjor dhe Monitorim të Komunave, që në bazë të kompetencës së MAPL-së sipas Nenit 76.1 që sipas Nenit 81 për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë në lidhje me nenin 82 par. 1 të kërkojë nga Kuvendi Komunal që të rishqyrtojë vendimet e nxjerra nga mbledhja e Kuvendit Komunal më datë 31.01.2014, duke sqaruar detajet e shkeljeve që ka bërë Kuvendi Komunal me rastin e nxjerrjes së këtyre vendimeve.

Shpresojmë se MAPL-ja do të veprojë në kohë sa më të afërt, dhe në këtë mënyrë do t'i kontibujë punës demokratike të institucionit të Kuvendit Komunal të Skenderajt.


Skenderaj, 10.02.2014



Ajnishahe Halimi – Lëvizja VETËVENDOSJE!



Cenë Behrami – Lidhja Demokratike e Kosovës



Qazim Xani – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës